



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1567/3 Prot.

Tiranë, më 30 /10 / 2019

V E N D I M

Nr. 156, Datë 30 / 10 / 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, mori në shqyrtim ankesën me nr.133, datë 23.10.2019, të znj.A. J, kundër ish-Kryetares, znj.V. D dhe Kancelares, znj.B. N, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, me objekt pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjeve politike*”, “*gjendjes ekonomike*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, znj.A. J në parashtrimet e sjella pranë KMD-së shprehet se për një periudhë prej 2 vitesh e 9 muajsh ka punuar në pozicionin e Sekretares Gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Ajo citon se: “*Fillimisht kam punuar si intership, pa*

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

pagesë për 9 muaj radhazi, ku jam shfrytëzuar nga Kancelarja për punët e saj të sekretarisë. Në momentin që fillova punë, së bashku me mua ishte dhe kushërira e ish-Kryetares së Gjykatës, znj.E.L, me të cilën ish- Kryetarja kishte lidhje familjare. Theksoj faktin se gjatë kësaj periudhe ajo ka qenë pa diplomë dhe është paguar me rrogë të plotë. Në këtë periudhë në emrin tim janë derdhur kontribute, por jam detyruar që rrogën time t'ia jap znj.E.L në dorë, për muajt Nëntor – Dhjetor 2014. Jam sharë, ofenduar dhe kërcënuar nga Kancelarja që do më zhdukë dhe do më heqë nga puna. Në momentin kur jam larguar nga puna, me datë 30 Shtator 2016, Kancelarja ka ardhur në zyrë duke mu drejtuar me fjalët: “Merri të gjitha zhelet e tua dhe largohu nga këtu”. Jam ndier e fyer, e poshtëruar dhe e diskriminuar”.

Në shpjegimin që subjekti ankues bën lidhur me secilin shkak, për të cilët dhe ka pretenduar diskriminimin nga ana e ish-Kryetares dhe Kancelares së Gjykatës, citon se:

- *Për sa i përket diskriminimit tim për “bindjet politike”, i gjithë stafi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, duke filluar nga Kancelarja e Gjykatës dhe duke përfunduar tek sanitarja, të gjithë i përkisnin Partisë së Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI). Unë kam hyrë në Gjykatë jo si pjesë e ndonjë strukture politike dhe bindjet e mija politike ishin krejt të ndryshme. Në një ambient ku lartësohej nga Kancelarja dhe kolektivi figura e A. Ç nga mëngjesi në darkë, ishte tërësisht e pamundur të punohej. Për më tepër bëhet fjalë për një institucion ku jepej drejtësia dhe partitë politike nuk duhej të lakoheshin. Jam diskriminuar pasi kam hyrë në këtë institucion pa ndërhyrjen e LSI.*
- *Për sa i përket diskriminimit tim për “gjendjen ekonomike”, shumica e punonjësve të Gjykatës, duke filluar nga ish-Kryetarja dhe Kancelarja, rridhnin nga një klasë e lartë, ku leku fluturonte. Unë i përkisja një shtrese të mesme dhe nuk isha në lartësinë e tyre për sa i përket të ardhurave. Jam ndjerë e diskriminuar pasi kolektivi ishte i ndarë sipas shtresave pasurore, një formë “bulling”, pasi bëhesha objekt talljeje për këtë fakt”.*
- *Sa i takon shpjegimit të “çdo shkak tjetër”, ankuesja citon se në këtë shkak referon fjalorin që Kancelarja ka përdorur përkundrejt saj, duke shprehur se ajo rrinte gjithë ditën me celular në dorë dhe se kishte hyrë dhe dalë nga institucioni/Gjykata edhe pasi është hequr nga puna.*

Referuar akteve dhe dokumentacionit të depozituar nga ankuesja, rezulton se marrëdhënia e punës mes saj dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka vijuar me intervale ndërprerje³ nga data 01.07.2014, kur daton dhe urdhëri emërimit në detyrë, deri më datë

³ Referuar Vërtetimit të pagesës së kontributeve, të DRT Shkodër “Për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”.

30.09.2016, datë kur i është zgjidhur marrëdhënia e punës. Marrëdhënia e punës nuk rezultoi formalizuar me kontratë pune, me përjashtim të një kontrate me afat dy muajor, të nëshkruar nga palët me datë 05.03.2015. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, në tagrin e punëdhënësit nuk ka formalizuar kontratën e punës nëpërmjet një akti shkresor. Rezultoi se palët janë dakortësuar nëpërmjet një kontrate verbale të punës, qoftë dhe nëpërmjet veprimeve konkludente: ankuesja ka ofrur punën, shërbimin dhe Gjykata ka përmbushur detyrimin e pagës kundrejt punës. Pas disa urdhërave të njëpasnjëshëm për lidhje të kontratës së punës me afat të përcaktuar në kohë, (nga dy në tre muaj) Gjykata ka shkëputur marrëdhëniet e punës me ankuesen me datë 30.09.2016 kur dhe mbaronte afati i kontratës së fundit verbale të punës, referuar urdhërit nr.8/1, datë 01.06.2016.

Subjekti ankues informon Komisionerin se çështjen e saj e ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata i ka rrëzuar pretendimet e saj dhe tani e ka apeluar në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë.

Në përfundim të ankesës, znj.A. J ka kërkuar konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave respektive për rregullimin e pasojave të ardhura si rezultat i tij, përmes rikthimit në pozicionin mëparshëm të punës ose dëmshpërblim me 15 paga bruto.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Bazuar në deklaratimet dhe në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues pranë Zyrës së KMD-së, Komisioneri, konstaton se:

- Subjektit ankues i është zgjidhur marrëdhënia e punës nga ana e Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, në tagrin e punëdhënësit, me datë 30.09.2016.
- Në kontekst të sa mësipër, **ankuesja ka marrë dijeni për këtë fakt, zgjidhjen e marrëdhënieve të punës** (për të cilin dhe pretendon diskriminimin), **me datë**

30.09.2016⁴. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 23.10.2019, pra më vonë se tre vite nga marrja dijani.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja dijani nga i dëmtuari, për këtë fakt”, ankesa e znj.A. J, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh, nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së znj.A. J, për shkak se është jashtë afatit për shqyrtimin e ankesave, sipas parashikimit të dispozitave të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONER

Robert GAJDA

⁴ Referuar deklarimeve të ankueses në formularin e ankesës, si dhe dokumentacionit të sjellë pranë KMD-së.

Fusha: Punësim

Shkaku: Bindjet politike, gjendja ekonomike